



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS**

Nr. 2232 Prot.

Durrës, më 20-4.2022

SHPALLJE 4

**E VENDIT TË LIRË PËR DREJTOR TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR (IPAP)**

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës , në zbatim të Ligjit 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar” i ndryshuar, shpall vendin e lirë të drejtorit të institucionet arsimore publik të arsimit parauniversitar IPAP bashkelidhur shpalljes:

1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për drejtor të IPAP:

- a) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”, me vlerësimin jo më pak se “ Mirë” , në kualifikimin e fundit.
- b) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;
- c) të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshme përgatitor për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor *ose* të jetë pranuar për të kryer atë.

d) Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

1. Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban:

- a) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkelidhur këtij udhëzimi);